REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I31-2 **Prot.** **Tiranë 27/08/2025**
Nr. Dok. 202502635/2

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Gramsh.*

Drejtuar: **Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan**

ELBASAN

Komisariatit të Policisë Gramsh

GRAMSH

Për dijeni: **Drejtues Madhor z. Ilir PRODA**

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi gjetjet e inspektimit që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisariatin e Policisë Gramsh më datë 17.04.2025.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, seksion pranë Avokatit te Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit"*, i ndryshuar, dhe nenin 81 të ligjit nr.81 /2020, "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*" kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë Gramsh.

Inspektimi u krye sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues morën pjesë znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi, me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.82/2024 "*Për Policinë e Shtetit*", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11. 2023 për miratimin e procedurës standarde *"Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së*

Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre" dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë".* Inspektimi ishte i paparalajmëruar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, që do të gjeni më poshtë:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisariatit z. Krenar Guçe i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, z. Guçe informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit referuar inspektimit të mëparshëm, lidhur me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit të këtij Komisariati sipas procedurave standarde dhe për rritjen e performancës së punonjësve të policisë për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar.

Në Komisariatin e Policisë Gramsh, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Nga monitorimi që iu bë zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë Komisariat kishte një dhomë magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale, provat materiale të administruara gjatë procedimeve penale nga specialistët e krimeve si dhe materialet e tjera ishin të paketuara dhe të emërtuara[1].

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve[2] të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se:

---

[1] Neni 215 i K.Pr.P. ka parashikuar shprehimisht:
Vulosja e sendeve të sekuestruara (Shtuar pika 4, 5 dhe 6 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)
"*1. Sendet e sekuestruara sigurohen me vulën e organit procedues ose, në varësi nga natyra e sendeve, me mjete të tjera të përshtatshme që tregojnë se ato ruhen për nevojat e drejtësisë. Krijimi i dhomave të depozitimit të provave materiale është masë parandaluese e cila shmang aktet e mundshme të dhunës psikologjike/fizike që mund të kryhen nga punonjësit e policisë gjatë marrjes në pyetje të personave.*
2. Organi procedues nxjerr kopje të dokumenteve dhe fotografi ose riprodhime të tjera të sendeve të sekuestruara që mund të ndryshojnë ose që ruhen me vështirësi, të cilat i bashkon me aktet dhe urdhëron ruajtjen e tyre në sekretari."

[2] *Rekomandim për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Gramsh nr. K4/I18-2 prot datë 24.06.2024.*

- ✓ **Nuk ishin marrë masat** për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit.
- ✓ **Nuk ishin marrë masat** për përdorimin e dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente.
- ✓ **Nuk ishin marrë masat** e nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

Në përfundim, grupi i inspektimit konstatoi se, ndonëse nga Komisariati i Policisë Gramsh ishin bërë disa herë kërkesa drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë (D.V.P.) Elbasan për mbështetje buxhetore[3] për plotësimin e rekomandimeve të lëna nga institucioni jonë, vërejmë me keqardhje se nga ana e D.V.P.-së Elbasan ende nuk ishin marrë masat e nevojshme për përmirësimin e standardeve lidhur me kushtet materiale dhe të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, që i gjeni si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë Gramsh, ambientet e shoqërimit ndodheshin në katin e parë të godinës të komisariatit. Ky mjedis përbëhej nga 3 (tre) dhoma shoqërimi për mbajtjen dhe trajtimin e personave të shoqëruar, nga të cilat 1 (një) dhomë për burra, 1 (një) për gra dhe 1 (një) për të miturit.

Sipërfaqja dhe hapësira e dhomave të shoqërimit ishin të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, me kushte për trajtim dinjitoz dhe garantimin e të drejtave që ligji iu njeh këtyre personave. Kapaciteti total i dhomave të shoqërimit ishte për 9 persona.

Dritaret e dhomave të shoqërimit kishin përmasa të tilla, që siguronin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral. Ato ishin të siguruara me zgarë hekuri, por **nuk** ishin të veshura me rrjetë teli me qëllim parandalimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme që përbëjnë shkak ose premisë për vetëdëmtim.

Të treja dhomat e shoqërimit ishin të lyera, të pastra nga ana higjieno-sanitare. Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej vetëm një tualet i cili përdorej nga gratë dhe të miturit i pajisur me çezmë dhe kishte ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje, ndërkohë që të shoqëruarit burra i dërgonin në tualetin e katit të dytë. Tualetet i plotësonin kushtet higjieno-sanitare, ishin të lyera dhe të dezinfektuara.

Në ambientin e shoqërimit kishte një zyrë pune për specialistët dhe ndihmës specialistët e policisë, e cila duhet të shërbente si dhomë për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar në mjediset e këtij Komisariati. Përgjatë inspektimit

[3] Referuar në shkresen nr. 100/3 prot., datë 8.07.2024 "*Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në Komisariatin e Policë Gramsh*" të DVP Elbasan ku referohen kërkesat zyrtare të dërguara nëpërmjet postës elektronike të Komisariatit të Policisë Gramsh (në datat 19.04.2024, 12.02.2024 dhe 10.07.2024).

konstatuam se personat e shoqëruar në mjediset e policisë, vijonin të intervistoheshin në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në zyrën e intervistimit. Zyrat e punës të punonjësve të policisë, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave për të vëzhguar veprimet procedurale që kryejnë me personat e shoqëruar. Avokati i Popullit e vlerëson shkelje të rëndë ligjore për sa kohë që infrastruktura, edhe pse jo e plotë ekziston.

Grupi i inspektimit konstatoi se ***mungonte sistemi i monitorimit me kamera*** për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit, si dhe zyrës ku merren në pyetje personat e shoqëruar. Në vijim të rekomandimeve tona, drejtuesi i Komisariatit Gramsh i është drejtuar zyrtarisht disa herë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan për realizimin e tyre dhe veçanërisht ka kërkuar pajisjen me kamera të ambienteve të shoqërimit të Komisariatit.

Mungesa e sistemit të monitorimit me kamera, kryesisht në dhomën për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, mund të përbëjë shkak për përdorimin e mjeteve dhe metodave jo të përshtatshme për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë, si dhe për respektimin dhe garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave. Mbikëqyrja me kamera e të gjitha mjediseve në komisariate, përveç atyre mjediseve ku cenohet privatësia, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e punonjësve të policisë së shtetit ashtu edhe nga ana e të shoqëruarve.
Së dyti, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisariateve, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.
Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që hartohen nga institucionet monitoruese të pavarura. Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë Komisariat zbatohej detyrimi ligjor i parashikuar në pikën 6 të nenit 19[4] e ligjit nr.82/2024 "*Për Policinë e Shtetit*", si dhe në Kapitullin VII, pika a.3.4[5] të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Në Komisariatin e Policisë Gramsh, gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 17.04.2025 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e

[4] Pika 6, e nenit 19 të ligjit nr.82/2024 "*Për Policinë e Shtetit*" i cili parashikon se: "*Punonjësi i policisë dokumenton veprimet e kryera me personin e ndaluar përkohësisht, sipas procedurave standarde të miratuara me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Një kopje e dokumentacionit i vihet në dispozicion personit të ndaluar përkohësisht*."
[5] Urdhër nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë"* parashikon në pikat *"a.3.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar: a.3.4 "Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimisht personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore*."

shoqërimit 86 persona, nga të cilët 82 burra dhe 4 të mitur. Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë shtetas në dhomat e shoqërimit.

Gjithashtu përgjatë inspektimit konstatuam se personave të shoqëruar nga policia **ju jepej informacioni për të drejtat e tyre në formë shkresore**, që nga fillimi i privimit të lirisë, për të siguruar informim të qartë në lidhje me të drejtat ligjore / procedurale që ata kanë.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës sugjeron dhënien e kartës të drejtave që në momentin e hyrjes në komisariat . Rekomandimi i MKPT-së, në përmbajtjen e tij nënkupton që karta me të drejtat që gëzojnë personat kur hyjnë në mjediset e policisë, duhet tu jepet edhe personave që mbahen në dhomat e shoqërimit, pra që në momentet e para të privimit të lirisë. Pasi këtyre personave ju kufizohet liria deri në 5 orë (maksimumi) qëndrimi në dhomat e shoqërimit, ata merren në pyetje nga specialistët e policisë dhe kanë të drejtën për njoftimin e familjarëve të tyre, të drejtën për qasje me avokat mbrojtës, etj.

Avokati i Popullit inkurajon pajisjen e qytetarëve me "Kartën e të drejtave" në rast shoqërimi në polici, që është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një komisariat policie. Nëpërmjet "Kartës së të drejtave" qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të policisë kundrejt tij.[6]

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë Gramsh nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisariatit të Policisë Elbasan. Së fundmi, për shkak të rikonstruksionit të Komisariatit të Policisë Elbasan, personat e ndaluar/arrestuar dërgoheshin në Bllokun e Sigurisë në Tiranë.

Regjistri i personave të shoqëruar, si dhe trajtimi i të shoqëruarve

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin Gramsh, "Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar" ishte plotësuar në zbatim të ligjit nr. 82 /2024 "*Për Policinë e Shtetit*", sipas tipit "Model nr. 1", konform procedurave standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë"* miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

---

[6] CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici).
Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t'u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit.
Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.24]. Konsulto: https://rm.coe.int/168097986b

Personat e shoqëruar në mjediset e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2024 "*Për Policinë e Shtetit*", regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezulton se koha e qëndrimit në gjendjen e shoqërimit të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri 5 orë në raste të veçanta.

Komisariati i Policisë Gramsh ishte i pajisur me regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën në momentin e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Gjithashtu, në këtë Komisariat administrohej regjistri për të miturit të shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, megjithatë u konstatua se rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 "*Kërkesë/ankesat e të shoqëruarve, të ndaluarve dhe të arrestuarve*" të ligjit nr. 82/2024 "*Për Policinë e Shtetit*", por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Ambientet e intervistimit

Në Komisariatin e Policisë Gramsh punonjësit e policisë i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës ndonëse edhe nga inspektimet e mëparshme në këtë komisariat kemi konstatuar se ishte përshtatur një zyrë për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar. Kjo zyrë dhe ambientet e komisariatit, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga punonjësit e policisë. Nga biseda me drejtuesit na u bë me dije se kjo zyrë **nuk** përdorej nga punonjësit për shkak të mungesës së bazës materiale e cila shërben për marrjen në pyetje të të shoqëruarit si kompjuter, internet etj.

Në Procedurën Standarde të Punës "Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë", me Urdhrin: nr. 894, dt. 19.07. 2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit përcaktohet qartë se: *Pranë dhomave të shoqërimit dhe pjesë të këtij sistemi projektohen dhe ndërtohen ambiente të posaçme si*: i.1 Dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen).

i.1.1 **Ky ambient përveç kushteve të përcaktuara për dhomat e shoqërimit duhet të plotësojë dhe këto kushte**:

Të ketë të instaluara tavolinë pune dhe karrige për oficerin e policisë gjyqësore dhe pajisje elektronike për dokumentimin e veprimeve procedurale që kryhen nga OPGJ (kompjuter, printer, letër, etj).

Tavolinë pune dhe dy karrige për qëndrimin e avokatit mbrojtës dhe të personit të dyshuar/akuzuar i cili do të intervistohet, arrestohet/ndalohet, etj.

Instalohen sisteme dhe pajisje për regjistrimin elektronik audio dhe video të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë si i arrestuar/ndaluar.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personit në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme si nga ana e punonjësve të policisë së shtetit ndaj tyre ashtu dhe nga vetë të shoqëruarit.

Lidhur me këto fakte, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar[7] në mënyrë të përsëritur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorive Vendore të Policisë, marrjen e masave për krijimin e zyrave të posaçme, për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse konstatohet nga inspektimet periodike të zhvilluara nga MKPT, ky rekomandim ende nuk është plotësuar.

Ndërkohë, vlerësojmë se në rastet e ndodhjes së ngjarjeve të rënda, si dhunime fizike, keqtrajtime apo të rasteve fatale të vdekjeve në ambientet e organeve të policisë, regjistrimi dhe ruajtja e filmimeve do të ishte një nga provat e rëndësishme për zbardhjen dhe identifikimin e autorëve të tyre. Me anën e regjistrimit audio-viziv mund të verifikohet dhe provohet nëse i arrestuari/ndaluari ka qenë ose jo i dhunuar para se të shoqërohej në organet e policisë, gjatë marrjes në pyetje para se të akomodohej në dhomat e sigurisë, apo është dhunuar brenda këtyre ambienteve, personat që e kanë takuar apo dhunuar, datën dhe orën e kryerjes së veprimeve të kundërligjshme, kryerjen e detyrave nga punonjësit e policisë të shërbimit të brendshëm, ofrimi i shërbimit mjekësor, etj. Për këto arsye, është domosdoshmëri monitorimi dhe ruajtja e regjistrimeve nëpërmjet të cilit do të mund të shmangen rastet e dhunës.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit ka rekomanduar marrjen e masave për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në veçanti në këto zyra dhe ambientet e shoqërimit, por është konstatuar se ky rekomandim nuk është plotësuar.

Avokati i Popullit, vlerëson se është i papranueshëm pretendimi i mospërdorimit të zyrës sepse nuk ka kompjutera. Gjetja e një njësie dhe vendosja e tij në këtë dhomë është një veprim administrativ që duhet të krijohet e t'i jepet menjëherë fund kësaj praktike abuzive. Ndërkohë interneti nuk është mungesë thelbësore për kryerjen e veprimeve ndaj është justifikim i pabazuar.

Ndihma juridike dhe psikologjike

[7] Rekomandohet krijimi i ambienteve (dhomave) më vehte të intervistimit/ marrjes në pyetje të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së shtetit. Nr.K4/I89-2Prot, Dat. 28.12.2023.

Përgjatë inspektimit u konstatua se ishte një listë e afishuar në ambientet e komisariatit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht, gjithashtu ishte evidentuar dhe në regjistrin e informacionit kur avokatët kishin qenë të pranishëm. Punonjësit e policisë na bënë me dije se, avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë Elbasan, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me Bashkinë e Gramshit.

Gjithashtu kjo problematikë është trajtuar në raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e Komitetit të Parandalimit të Torturës (KPT) në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

KPT-ja bën rekomandime të hartuara për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Kërkohet gjithashtu veprim për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë. KPT-ja gjatë vizitës në organet e policisë së Shtetit ka konstatuar se: "*Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar* ***për avokat kryesisht*** *vetëm pas një vonese të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t'i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati*"[8]. Avokati i Popullit thekson se është e një rëndësie të veçantë afishimi në ambientin e shoqërimit të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i arrestuari/ndaluari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokat mbrojtës.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, ata shoqëroheshin për në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, për kryerjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit për të miturit dhe në praninë e detyrueshme të kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Gjatë inspektimit u konstatua se, brenda në dhomat e shoqërimit, ishin afishuar kartat me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë, si dhe të personave të ndaluar/arrestuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Megjithatë në korridorin e ambientit të shoqërimit mbeteshin ende të afishuara posterat e vjetra me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë dhe këto postera afatin maksimal të shoqërimit e kishin 10 orë. Për pasojë në shumë raste mund të kthehet në keqinformim të personave të shoqëruar. Në ligjin e ri "*Për Policinë e Shteti*".[9] përcaktohet se afati maksimal i shoqërimit është **5 orë**. Afishimi i këtyre kartave ndihmon në rritjen e transparencës dhe ndihmon qytetarët të kuptojnë se si të mbrojnë të drejtat e tyre gjatë interaksionit me policinë. Duke qenë se ky është një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të besimit mes publikut dhe institucioneve të rendit, do duhet zëvendësimi i tyre sa më shpejt me postera të rinj.

---

[8] https://rm.coe.int/1680ae233b, *fq nr.3, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.*

[9] Ligji i ri nr.82/2024 "Për Policinë e Shtetit", i cili ka hyrë në fuqi në datë 23.08.2024.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisariat zbatohej detyrimi ligjor i parashikuar në pikën 6 të nenit 19 të ligjit nr.82/2024 "*Për Policinë e Shtetit*", si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*" dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*", me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për përdorimin e dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente.
3. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
4. Marrjen e masave të nevojshme për vendosjen e rrjetës së telit të zgarës së hekurit në dhomat e shoqërimit, me qëllim parandalimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme, të vetëdëmtimit, të personave të shoqëruar nga këto mjedise.
5. Marrjen e masave për zëvendësimin e menjëhershëm të posterave me të drejtat e personave të shoqëruar në ambientet e shoqërimit me postera të rinj për shkak të ndryshimeve të fundit ligjore.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)

Ahmet PRENÇI
d.v